

KËRKIME GJUHËSORE

Nikoleta KALLDRËMXHIU

DISA GJEDHE FJALËFORMUESE TE KADAREJA

Të folmet e popullit nuk mund të jenë kurrë edhe të folmet e bukura të një foltari, të një historiani, të një letrari a të një filozofi. Për të mbuluar sfera të leksikut dituror shkrimtarëve tanë shpesh u është dashur t'i drejtohen neologjizmit e kjo e arrirë kur është bërë pas shpirtit e rregullave të gjuhës. Në historinë e letërsisë së çdo populli, kanë dalë shkrimtarë të cilët e kanë përtërirë thesarin e gjuhës kombëtare me fjalë të reja ose sipas modeleve të gjuhëve më të arrira e nga të përdorurit e gjallë të tyre prej popullit. I. Kadare është nga ata autorë krijimtaria e të cilit ka mjaft interes nga pikëpamja e formimit të fjalëve të reja, si një mënyrë mjaft e efektshme për pasurimin e rigjallërimit të leksikut të shqipes dhe siç do ta shohim në këtë mëtim të shkurtër ndjek prirjet e sotme të fjalëformimit të saj. Objekt i kumtesës janë ato neologjizma të bëra me fjalë që i ka gjuha me prapashtime analogjikisht me fjalët që përdoren rëndom; mjetet dhe rrugët fjalëformuese që janë shtënë në punë për krijimin e tyre. Pse u zgjodh modeli prapashtesor? Sepse kultin e tij për gjuhën autori e ka shprehur te “Prapashtesat e përgjakura”.

Në kundërshtim me zotërimin e një psikologjie intelektualiste në përdorimin e mjeteve të shprehjes gjuhësore, fraza e pastër shqipe vjen si shenjë e një kulture të lartë, duke bërë që fjala e gjallë artistike të luaj një rol të dorës së parë në kristalizimin e gjuhës së përpunuar dhe asaj në përpunim të ligjërit shqip. Duke u ndalur në sferën e leksikut ku përdoren këto fjalë arrijmë të dallojmë pasurimin e drejtpërdrejt që shkrimtari i ka prurë shqipes, duke vlerësuar paraprakisht si ndërthurje të asaj çka është populllore, diturore e shqiptare.

Fjalëkrijime me prapashtesa të njohura, të përdorura në mënyrë vetjake, por edhe duke ndjekur rregullat e fjalëformimit.

I. me prapashtesën –s¹. formimi i emrave dhe mbiemrave nga tE dhe tF

Sistemi i fjalëformimit të shqipes standarde mbështetet në radhë të parë në mjetet dhe tipat fjalëformues të gjuhës popullore, por një numër fjalësh janë formuar sipas fjalëve përkatëse të gjuhëve të zhvilluara. Formimi i kalkeve ka qenë, një nga rrugët më të frytshme për pasurimin e fjalorit në gjuhët europiane. Këto kalke strukturore që pajtohen me tipat e fjalëformimit të shqipes vërehet sidomos në formimin e emrave të vepruesit me prapashtesën –s (nomina agentis²), që është risi në fjalëformimin e saj dhe siç vihet re edhe nga tabela janë emra konkretë të karakterizuar sipas veprimit që bëjnë, p.sh emra më vete, si: arratisës; dhënës, gërmihës, humbës ose tema emërore në kompozita emërore që prodhojnë emra konkretë. Formim tjetër është sipas profesionit, emra si *ëndërres*, *thashethems*, *dhjatës*, *gremins* etj.

¹ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë 2002, f. 133.

² Th. Dhima, Mbi produktivitetin e disa mjeteve fjalëformuese, Gjuha jonë, 1984, nr. 3, f. 36.

Modelit TE ose tF+ -(ë)s > E³ ku struktura e lidhjes fjalëformuese është më e thjehtë bëhet nëpërmjet një kalimi metonimik (përdoret mjeti në vend të punës që bën.)

Tipi analitiko-sintetik i formimit të emrave konkret që emërtojnë njerëz sipas emrave të veglave a sendeve të përdorimit të përditshëm si; *busullmbajtës, festëprishës, ferexhesjellës, gjysmëshëronjës, cfinafutës, gjumëprishës, ikonashitës* duke prurë emra njerëzit sipas profesionit që ata kryejnë, emra që shënojnë pjesë të trupit të njeriut ose jo, si: *buzëqeshës*. Tema e kompozitës s'është shuma e thjeshtë e temave emërore përbërëse dhe si pjesë potenciale e leksikut mund të krijoj antonimi. Bërthama semantike e fjalës së parë mban peshën, kurse e dyta luan rol modifikues pothuaj të përafërt me atë të prapashitesës.

Ndryshojnë fjalëkrijimet me gjysmë, dilemën dhe hamendësimin kaq karakteristike për Kadarenë: gjysmëpërqeshës, gjysmëshpotitës, gjysmëshpërfillës, gjysmëmetallës dhe hatërmbetës.

Emrat që shprehin pësuesin a bartësin e veprimit duket se autori ta ketë vjelë nga parapëlqimi i variantit geg -s e shndërron në gjuhën letrare artistike, si *baltës, vdekës, qurrs, dyts*, etj. (Sipas tipit të formimit të emrave të GVP, fjala e re shënon emrin që bëhet bartësi i këtij tipari). Disi e papërligjur për rregullat e fjalëformimit të shqipes për cilësitë modifikuese të prapashitesës.

Mbiemrat⁴ *dybesims, bars, dymoshës*, – megjithëse ky model është i zakonshëm në formimin e mbiemrave, tema e fjalës përgjithësisht e favorizon atë dhe sidomos në dy rastet e para. Marrëdhënien e sendit të karakterizuar ndaj një veprimi të shprehur nga tema prodhuese (folje). Kuptimi del më i qartë në rastin kur tema emërore vjen nga folja dhe që përputhet me rregullat fjalëformuese.

Këto fjalë si rezultat i zhvillimit fjalëformues e kanë zgjeruar vëllimin e tyre semantik⁵, Ato shfaqin ndryshime në kateqoremë si shfaqet *buzëqeshës, besëprerës* etj.

Me interes jo vetëm për fjalëformimin është integrimi në gjuhën e shkruar i tipit të temave fjalëformues të gegërishtes me -ue, - ye si fjalë më vetë dhe si përbërëse tematike emërore të kompozitave përkatëse; *brenggërryes, befasues* me të cilën autori zëvendëson origjinal, *delirdërgues, makthdërgues, ëndërrshkrues, fenershues, gjakshlyes* etj. Themi se edhe ky tip është i afërt ose pothuaj i plotë me rregullat dhe prirjet e sotme të fjalëformimit të shqipes.

Shtimi i vëllimit semantik duket në shfaqjen e sinonimisë, dhe zhvillimit të çerdhes fjalëformuese si ndodh me të *ëndërr*. Kompozitat e saj mund të krijojnë antonimi dhe kjo i takon leksikut potencial apo fjalë të tilla si bezdisës shfaqen si polisemantike.

II. *Formimi me paranyjëzim e prapashitesën – (ë) t (ë)* ⁶ formimi i mbiemrave⁷ nga tE,tN është i rëndomtë, por mjaft prodhimtar në shqipen e sotme. Kemi modelin e

³J. Thomaj, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 233-245.

⁴A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, Studime filologjike, Tiranë, 1972, nr. 3, f. 61.

⁵J. Thomaj, N. Kalldrëmxhiu, *Fjala zemër në gjuhën shqipe*, Tiranë 1996, f. 40.

krijimit të mbiemrave nga tema emërore *dallandyshtë (i)*, *memectë (i)*, *shkretëtirtë (i)*, *tymtë*, *vrugtë (i)*, *por edhe me temë ndajfoljore kurrfartë (i)*

Mbiemra lëndorë: *i tymtë*, *i drurtë*, *i dallandyshtë*

Mbiemra cilësorë: *i trishtë*, *i zgropët*, *i memectë*, *i vrugtë*, *i shkretëtirtë si dhe kompozitat flokëakullt*, *fytyrqelqët*; të përngjiturit *i kundërtiellt*, *i pambarimtë*, *i tjetërfartë*, *kurrfartë etj.*

Kalimi metaforik nga emër në mbiemër i jep një nuancë përforcimi fjalës së re. Për shkak të abstraksionit leksikor zhvillimet semantike kualitative, përdorimet mbiemërore të fjalëve e kanë zgjeruar vëllimin e tyre semantik.

III. *prapashtesa* – (n) *ajë* për formimin e emrave abstraktë e konkretë dhe ndajforljeve nga tE, tP dhe tN

Te Kadareja gjejmë ndajshtesa fjalëformuese me elemente vendëse të përbashkëta për të gjithë gjuhën. Në këtë inventar janë integruar dhe janë bërë aktive dhe ndajshtesa me burime dialektor geg, si, p.sh *prapashtesa* – (n) *ajë*⁶. Nga pikëpamja strukturore ky tip ka formime jo vetëm me emra me temë emërore, si: *tymanajë*, *lulnajë*, *prushnajë*, por edhe përemërore gjithnjë e ndajfoljore gjithkahnajë. Ky ndërtim analogjik me *prapashtesa* – (n) *ajë* del jo vetëm si një ndajshtesë e specializuar të fjalëve që tregojnë vend pra një leksik i specializuar gjeografik (*lulënajë etj.* por edhe koncepteve abstrakte me funksion artistik të fuqishëm siç janë *pabesnajë*. ku modifikimi i ndajshtesës për formimin e emrave ka prurë kuptim e përmasave të mëdha hapësinore që ka bërë këmbë edhe në gjuhën e sotme shqipe. Fusha leksikore e fjalëve gjeografike e zoologjike e botanike: *bornajë*, *gjithkahnajë*, *gjethnajë*, *pluhurnajë*, *shpendajë*, *pyllnajë*, *plehnajë*, *rrugnajë*, *sheshnajë*, *shkurnajë*, *prushnajë*. Ato i përkasin leksikut dituror e terminologjik.

Dhe mund të zhvillohet më tej kur dihet se shqipja është një gjuhë që e ka ndërjerë mungesën në terminologji. Pavarësisht semantizimit dhe humbjes së mëvetësisë kuptimore ndajshtesa e specializuar ka një jetë të saj të mëvetësishme. Kalimi bëhet me anë të një metonimie. Një pjesë e këtyre fjalëve kanë zhvilluar kuptime të figurshme dhe janë edhe polisemantike, si *pabesnajë*, *floknejë*, *gjethnajë etj.*

V.-ri⁹ *prapashtesë* e toskërishtes për formimin e emrave konkretë dhe abstraktë nga tE dhe mbiemrave.

Me *prapashtesën -ri* formohen kryesisht emra ku kjo *prapashtesë* u shtohet emrave që u ngjajnë mbiemrave siç është modeli *dhelperi* që tregojnë veçori ose cilësi abstrakte. Përveç formimeve tipike analogjike neologjistike të kësaj natyre gjejmë edhe një gjedhe disi të veçantë, ku emrat e formuar tregojnë

⁶ A. Dhimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, Studime filologjike, Tiranë, 1972, nr. 3, f. 67.

⁷ Th. Dhima, *Mbi produktivitetin e disa mjeteve fjalëformuese*, Studime filologjike, 1984, nr. 3, f. 36.

⁸ Po aty, f. 35.

⁹ Th. Dhima, *Mbi produktivitetin e disa mjeteve fjalëformuese*, Gjuha jonë, 1984, nr. 3, f. 38

⁹ *Gramatika e gjuhës letrare shqipe*, Tiranë 2002, f. 139.

sasi të madhe në përputhje me veçoritë e emrit përkatës e ngjashme kjo me natyrën e prapashtesës –*najë*, në fjalë si *lotëri e gurëri, e qelqëri, dimëri* etj. Pra kemi çifte prapashtesash sinonimike që tregojnë për një tjetër zhvillim gjuhësor.

Tipari i zmadhimit i përfaqësuar me prapashtesën -ri jep imazhin e një hiperbole që sintetizohet me një ekonomi të fjalës që i jep gjuhës edhe konkretën edhe imagjinatën njëkohësisht. Për të shprehur këtë autori zgjedh modelin prapashtesor, p.sh *Kush e solli Doruntinën*: “Nën atë lotëri fytyra e saj dukej më e largët” që ndoshta edhe vetë Shekspirit i është dashur që fjali e tërë për të dhënë imazhin hiperbolik të tragjedisë së tij. Krahajo “*kjo dorë i skuq dhe i përgjak të gjitha detet*”. Me anë të krijimit ai shmang ndërtimin frazeologjik i *shkonin lotët rrëke*.

Prapashtesa –ri është ndërtim analogjik ku kjo e fundit modifikon kuptimin duke treguar gjendjen sipas cilësisë së emrit, e përforcon e rrit ose e bën të madh tiparin e këtij të fundit. Me anë të kësaj prapashtese te Kadareja formohen si emra abstraktë, ashtu edhe konkrete që është gjedhe më vete. Të tillë kemi emrat përmbledhës me strukturë te -ri, si, *murgeshëri, qelqëri* i ndryshëm nga *qelqurinat*.

Fusha konceptore e emrave të vendeve sipas emrave të kafshëve si breshkëri, i cili është një ndërtim analogjik sipas Shqipëri. Variantin *krimbëri* e gjejmë te Konica *krimbësi*¹⁰.

Prapashtesa të tjera. Ndryshe nga ndajfoljet me – shëm¹¹, dikur një veçori e GV e përdorur shumë te Kadareja, mund të shërbejë për plotësimin e vargjeve fjalëformues. Disa gjedhe të formuara në këtë mënyrë mbeten disi jashtë rregullave të fjalëformimit¹². --shmëri emrave abstrakt me këtë prapashtesë, si; dypeizashmëri (ndërtim sintetik), përditshmëri, tejetshmëri janë ndërtime analitike është formë kalke që është risi në fjalëformimin e shqipes.

Modele të tjera popullore – *uc*¹³ në kuptim keqësues *njerëzucë, shtetucë, ylluc*.

Prapashtesa -isht modifikon kuptimin kategorial të fjalës, me të cilin nga emër kthehet në ndajfolje duke fituar kështu kuptimin e mënyrës së kryerjes së veprimit. Duke pasur parasysh përdorimin geg pa – *isht* dhe pa parafjalë si: *posaçe* te Camaj, themi se ky formim mund edhe të mos zgjerohet së tepërmi në shqipen e sotme, pasi shkurtesat apo dhe fjalët e shkurtra janë një prirje mjaft e pëlqyer e gjuhëve sot.

Potenciali semantik duket në shembujt polisemisë të fjalëkrijimeve; të sinonimisë brenda këtyre formimeve, si: *dybesims dhe dyfetari, dyemëri dhe dyemërsh* etj.

Prodhimtaria më e madhe e mjeteve të tij vjen ngaqë bashkohen me tema emërore, mbiemërore e ndajfoljore që janë edhe klasat më të pasura të leksikut të shqipes. Këto formime pasurojnë stilit libror; prapashtesat dialektore integrohen si

¹⁰ E. Lafe, *Për neologjizmat e F. Konicës*, Studime filologjike, 1995, Nr. 1-4, f. 56-58.

¹¹ N. Sotiri, *Fjalor i gjuhës së I. Kadaresë*, Tiranë 2007, f. 13.


¹² Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë 2009, f. 198-199.

¹³ Po aty.

DISA GJEDHE FJALËFORMUESE TE KADAREJA

pjesë organike e gjuhës. Kadareja në fjalëkrijimin prapashtesor zhvillon prirjet e sotme të shqipes¹⁴. Si i tillë stili i tij shquhet për elegancë dhe finesë, sepse ai ndërthur kalket, modelin me prapashtesën geqe, po aq edhe atë toske, duke zbatuar parimin e funksionimit të dialekteve si enë komunikuese. Ai është vazhdues i traditës fjalëkrijuese të shkrimtarëve shqiptarë. Këto gjedhe fjalëformuese janë përdorur edhe nga shkrimtarë të tjerë si te Naimi¹⁵, si *thirrës*, *shtjes* apo me *-ri mituri*, *robëri*, *dhelpëri* që kanë zënë vend edhe në shqipen e sotme.

Fjalëkrijimi te Kadareja është një veprimtari krijuese e drejtuar nga rregullat fjalëformuese të shqipes. Si vargu fjalëformues ashtu edhe afria kuptimore krijojnë një zonë të gjerë heterogjene ndërmjet karakteri prodhimtar dhe rregullsia e përsëritjes së morfemave. Me vërejtje shohim se neologjizmat e Kadaresë të krijuara sipas modelit prapashtesor janë të zhvilluara mirë përgjatë boshtit paradigmatic, atij kuptimor dhe kategorial. Shembull janë formimet me borë që kanë një varg të gjatë fjalëformues një pjesë e çerdhes me kuptim neologjik si te *bornajë* me varg *borëron*, *borëton* vetv, *borës~mb*, *borëtar~m*, *borëtim~m* apo *humnerë*, *ëndërr*, *ankthshëm*, *ankueshëm* etj.



Një pasurim që Kadareja i sjell gjuhës më këtë gjedhe është edhe pastrimi nga huazimet *gjithnjë-kozmos*, *i acartë -nevrik*, *fortafolës -megafon*, *i afërt -intim*, *befasues - origjinal*, *i zhvendosshëm -i çmontueshëm*, *cfinafutës - intrigant* etj. Krahës neologjizmit në vend të fjalës së huaj, përdor edhe fjalët e huaja nga gjuhët neolatine kryesisht me funksione artistike të theksuara, gjë që tregon për një stil të ekuilibruar dhe duke qenë një vepër kryesisht me karakter universal përforcon shprehjen e Sapir se gjuhët, sikurse qytetërimet rrallëherë i mjaftojnë vetëm vetvetes.

Ajo që vërehet lehtë është se fjalëkrijimet¹⁶ e Kadaresë ¹⁷nga fjalë të zakonshme u kthyen në fjalë poetike dhe të figurshme b) koncepte abstrakte

¹⁴ E. Hysa, *Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare*, Gjuha jonë, 1995, nr. 1, f. 44.

¹⁵ E. Lafe, *N. Frashëri dhe fjala shqipe*, Studime filologjike, 1990, nr. 4, f. 100.

¹⁶ N. Sotiri, *Fjalor i gjuhës së I. Kadaresë*, Tiranë, 2007.

¹⁷ A. Vehbiu, *Fjalët e krijuara nga shkrimtarët tanë*, Gjuha jonë, 1996, nr. 4, f. 57-59.

kryesisht me karakter dituror¹⁸, por nuk mungojnë ato konkrete c) fjala bisedore e huazuar e zëvendësuar në atë shqip (ana praktike) të ligjërimit të shkruar; d) fjala e rrallë e ricikluar. Duke qenë librore neologjizmin e pranojnë me lehtësi, i jep kohë përdoruesit të shqipes të përvetësojnë një pasuri leksikore sa më të madhe e të përshtatshme për të përballuar komunikimin në të gjitha fusha e jetës. Duhet theksuar se në këtë veprimtari kombëtarja¹⁹ është edhe estetike, duke dëshmuar për një punë të spikatur prej gjuhëtari, duke u bërë qëllimi i një gjuhëtari atdhetar. Fjalë të veçanta megjithëse nuk i përgjigjen ligjësive të formës, gjedhes a klisheë gjuhësore, mund të justifikojnë shmangien me përmbajtje, me vlerësimin se fjala me peshë është ajo që bie mesazhe.

¹⁸ E. Lafe, *Shqipja standarde në vështrimin strukturor dhe funksional*, Gjuha jonë, 1996.

¹⁹ *Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*, Tiranë 1973, f. 140.